



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	14.03.2024 01-01-10-4002
Për:	Arbënesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Propozim Vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale



Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 58 shkronja (h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 18 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, me qëllim të formimit të komisionit të ankesave i cili do të shqyrtojë ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, Kryetari i Komunës së Gjakovës me datë 14.03.2024 e parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

PROPOZIM VENDIM

- Kuvendi i Komunës të formojë Komisionin e Ankesave i cili do të shqyrtojë ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.
- Kryetari i Komunës propozon dy (2) anëtarë nga ekzekutivi i komunës, Kuvendi i Komunës propozon dy (2) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga radhët e subjekteve politike dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar.
- Ky Komision i Ankesave ka për detyrë dhe përgjegjësi që të shqyrtojë ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi.
- Mandati i Komisionit të Ankesave është dy (2) vjeçar brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.

Me respekt!